



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:239062
Datë: 27.01.2023
Numri i dokumentit: 03912588

C-IV - 14- 6942

Paditës: A I nga K e V, të cilin e përfaqëson av H L nga Vitia .

Kundër

Të paditurës : Ndërmarrja Shoqërore N ,, A ” në likuidim të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në Prishtinë, Rr. ,, Driton Hoxha ”, nr. 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me dt. 25 janar 2023, mori këtë :

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa/kërkesa e paditësit.**
- II. NDRYSHOHET Vendimi i Autoritetit Likuidues GJI 035- 0239 , dt. 01.10.2014, ashtu që obligohet e paditura NSH N ,, A ” që paditësit A I, për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, t’ ia paguaj për 3 (tre) paga në shumën 600.00€, sipas nenit 40 paragrafi 1. pika 1.6 .2, e Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.**
- III. Secila palë i heqë shpenzimet e procedurës .**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 06.11.2014, pranë DHPGJS është parashtruar ankesa/ kërkesa e paditësit, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH N ,, A ” GJI 035- 0239 , dt. 01.10.2014, me të cilin është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën 600.00€ .

Paditësi ka theksuar se ka punuar në ,NSH ,, A ” deri në momentin kur ka filluar procedura e likuidimit, më dt. 25.11.2005.

Mua padrejtësisht me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit më është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën 600.00€, për tri paga .

Ka kërkuar që të miratohet ankesa/ kërkesa e tij dhe të obligohet e paditura t' ia kompensoi tri paga bruto në shumën 600.00€ .

Kësaj parashtrese ja ka bashkangjitur :

- Kopjen e Librezës së punës ,
- Njoftimin për ndërprerje të kontratës së punës dt. 25.11.2005 .

Më dt. 04.07.2022, Dhoma e Posaçme Gjykatës Supreme ka lëshuar Urdhër C- IV-14- 6942, me të cilën i ka kërkuar paditësit të plotëson ankesën/ kërkesën e tij me dorëzimin e provave.

Më dt. 19.07.2022, dorëzuesi i postës në fletë dorëzim ka konstatuar se pala gjendet në Zvicërr.

Më dt. 26.07.2022, AKP-ja përmes përfaqësuesit ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj ankesës kundër Vendimit GJI035- 0239 të AL , me propozim që ankesa të refuzohet .

Në parashtresë është deklaruar se NSH N „A ” ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 25.10.2005, ndërsa më dt. 26.08.2014, parashtruesi regjistroi një kërkesë për dëmshpërblim për ndërprerje të kontratës së punës në shumën 600.00€.

Më dt. 02.10.2014, AL mori Vendimin GJI 035- 0239, me të cilin e ka refuzuar kërkesën .

Vendimi është mbështetur në fatet dhe bazat ligjore në vijim :

- Neni 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034, për AKP-në, parashikon „, elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë. Kërkesa apo pretendimi është i pas afatëshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme ” .
- Neni 608 i Ligjit për punën e bashkuar parashikon që pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkuar për tre vite.

Në bazë të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjykatë apo te ndonjë autoritet tjetër brenda afatit prej tri viteve nga momenti kur NSH të mos ketë përmbushur obligimin e tij të më hershme, ose deri në qershor të vitit 2008.

Më dt. 28.12.2022, paditësi përmes postës e ka pranuar Urdhrin dt. 04.07.2022.

Më dt. 06.01.2023, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar se paditësit ju është ndërprerë kontrata e punës më dt. 25.11.2005, kur ja ka dorëzuar njoftimin AKM-ja, për shkak të privatizimit dhe se paditësi nuk ka dokumentacionin sepse objekti i të paditurës është i djegur .

Paditësi ka aplikuar për kërkesën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën 600.00€, ose për tre paga nga 200.00€.

Ka bashkangjitur :

- Kopjen e dokumentit identifikues,
- Vendimin e AL GJI 035- 0239,
- Regjistrin i 20 %,
- Njoftimi dt. 25.11.2005.
- Konfirmimi i policisë për zjarrvënje , dt. 19.04.2011.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa/ kërkesa e paditësit, është e bazuar pjesërisht .

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 398 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i ka ofruar paditësi, dhe pretendimet në kërkesë si dhe pretendimet e të paditurës në parashtrës të mbrojtjes dhe provat e dorëzuara , ka konstatuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi ishte punëtorë i të paditurës, deri në ditën kur të njëjtit ju është dorëzuar njoftimi për përfundimin e kontratës së punës, më dt. 25.11.2005, për shkak të shitjes së aseteve të NSH –së. Si kontestuese është parashkrimi i kërkesës.

Me njoftimin, dt. 25.11.2005 të lëshuar nga AKM-ja , paditësi është informuar në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës, ndërsa sipas njoftimit „Shuma – Pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me P do të mbesin përgjegjësi e Punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura ”.

Me dokumentin e Kopjes së Librezës së punës, për A I i lindur më dt. 23.08.1963, i njëjti ishte i punësuar te e paditura dhe kishte përvojë pune 13 vite e 7 muaj e 10 ditë.

Me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI 035- 0239, dt. 01.10.2014, për NSH N „ A ” kërkesa e ushtruar nga A I për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën 600.00€, është refuzuar duke u mbështetur në nenin 36.2.1, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, dhe nenin 608, të Ligjit për punën e bashkuar.

Gjykata vlerëson se dokumenti i njoftimit i dt. 25.11.2005, i lëshuar nga AKM-ja me të cilin paditësit i ka përfunduar punësimi si pasojë e shitjes së aseteve të NSH , ka prodhuar efekt juridike si për paditësin si punëtor ashtu edhe për NSH „A ”, si punëdhënës, sa i përket pushimit të marrëdhënies së punës .

Po ashtu e paditura me të njëjtin dokument e ka pranuar faktin se shumat- pagat , të cilat nuk ju janë paguar punëmarrësit mbesin si përgjegjësi e punëdhënësit, dhe kërkesa e tillë do të shqyrtohet në procedurën e likuidimit, duke marruar për obligim që paditësi të kontaktohet kur të fillon kjo procedurë .

Gjykata vlerëson se në kohën kur paditëses i ka pushuar marrëdhënia e punës, dt. 22.11.2005, si Ligj i punës në fuqi, ka qenë Rregullorja nr. 2001/27, për Ligjin Themelore Të Punës në Kosovë, si dhe Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD i RSFJ i vitit 1978), që ka rregulla të përgjithshme në lidhje me parashkrimin e kërkesave .

Gjykata vlerëson se çështja e kompensimit të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është e rregulltar me nenin 12, të Ligjit themelor të punës, për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike dhe strukturore në ndërmarrje .

Me dispozitën e nenit 40 paragrafi 1. pika 1.6 .2, e Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, është parapa ,, kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në ” .

Gjykata vlerëson se nisur nga fakti se kërkesa kreditore, është ushtruar më dt. 26.08.2014, para Autoritetit të Likuidimit, ndërsa njoftimi për ndërprerje të punësimit është lëshuar nga AKM , dt. 25.1.2006 , me të cilin ka pohuar pagat e mbetura borxh, ky njoftim ka efektin juridikë të ndërprerjes së parashkrimit sipas dispozitës së nenit 387 të LMD-së (RSFJ) . Në rastin konkret pas ndërprerjes së parashkrimit, parashkrimi fillon të rrjedh përsëri nga fillimi, kurse koha e kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim, krejt kjo sipas dispozitës së nenit 392 , paragrafi 1, të LMD –së .

Mirëpo nisur nga fakti se AKP-ja, ka marr për obligim ta njoftoi paditësen kur të fillojnë procedurat e likuidimit, ndërsa fillimi i procedurës së likuidimit është varur nga veprimi i AKP-së (si shkak i pezullimit) , kjo situatë juridike ka ndikuar që rrjedhja e parashkrimit të pezullohet, pra fare të mos filloi të rrjedh parashkrimi, dhe një qëndrim i tillë mbështetet në analogji të dispozitës së nenit 384, paragrafi 1, i Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve i RSFJ.

Në rastin konkret për shkak të pezullimit të rrjedhjes së parashkrimit, parashkrimi fare nuk ka rrjedh deri në ditën kur paditësi është njoftuar për fillimin e procedurës së likuidimit nga AKP-ja , sipas vendimit të Bordit të AKP-së.

Gjykata vlerëson se pas konstatimit të kësaj gjendje faktike, e cila ndryshon nga konstatimi i gjendjes faktike nga Autoriteti i Likuidimit, Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar në mënyrë të gabuar faktin se është parashkruar kërkesa dhe si rrjedhojë e kësaj ka zbatuar në mënyrë të gabuar edhe dispozitën e nenit 36.2.1, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 .

Në Vendim por edhe në përgjigje në mbrojtje të AKP-së, nuk është bërë ndonjë kundërshtim në lidhje me lartësinë e pagës mujore , në shumë 200.00€ .

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësit nuk ju është parashkruar kërkesa kreditore dhe se të njëjtit, ju njihet e drejta për kompensimin të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Bazuar në faktin se paditësi kishte stazh punë 13 vite , ndërsa sipas nenit 12, paragrafi 2, pika (dh) nën (III) , të Ligjit Themelor të Punës i vitit 2001, ku është paraparë për 10 vite deri në 19 vite stazh pune, punëtorit i takojnë 3 (tre) paga mujore . Ashtu që në rastin konkret duke marrë për bazë pagën mujore 200.00€, për tre paga është gjykuar shuma 600.00€.

Meqenëse Gjykata, ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike si më lartë në bazë të provave të dorëzuara nga palët ndërgjyqës dhe pretendimeve të tyre, nga ajo që është vërtetuar nga Autoriteti i Likuidimit me Vendim të ankimuar, Gjykata vendosi që Vendimi GJI 035- 0239, të ndryshohet dhe ta pranoi ankesën/ kërkesën , duke vendosur si në dispozitiv .

Gjykata me rastin e pranimit të kërkesës së paditësit për pagat e pa paguara, ka zbatuar dispozitën e nenit 40 paragrafi 1, pika 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit, nr. 04/L-034 .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos që secila palë ti heqë shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva

Gjyqtar